

## MARREVESHJE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 30.06.2021, ne Tirane, palet e kesaj Marreveshje Shit-blerje Kuotash (“**Marreveshja**”), rane dakord si me poshte vijon:

**INTEL MEDIA Sh.p.k**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar ne perputhje me ligjin shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS K82803409T, date 03.04.2008, me zyre qendrore te regjistruar ne adresen: Lagja Apollonia, Rruga Sheshi Fitorja prapa Foto Studio Rustemi, Fier Shqiperi, ne cilesine e Ortakut qe zoteron 1 kuote qe korrespondon me 18,18% te kapitalit te regjistruar te shoqerise “ApNet” sh.p.k perfaqesuar nga administratori Z. Hamza Himo

dhe

**TEEB-CENTER Sh.p.k**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar ne perputhje me ligjin shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS K43219401P, date 19.08.2004, me zyre qendrore te regjistruar ne adresen: Lagja Kongresi i Permetit, Bulevardi Jakov Xoxa, Pallati nr 5 Kati i I-re. Fier, Shqiperi, ne cilesine e Ortakut qe zoteron 1 kuote qe korrespondon me 81,82% te kapitalit te regjistruar te shoqerise “ApNet” sh.p.k perfaqesuar nga administratori Z. Ilir Nathanaili

me poshte referuar vecmas si “**Shitesi**” dhe se bashku si “**Shitesit**”;

dhe

**Vodafone Albania” Sh.A.**, shoqeri aksionere e themeluar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT K11715005L, me seli në adresën: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Rruga “Pavarësia”, Nr. 61, Kashar, Tiranë, Shqipëri, perfaqesuar rregullisht nga administratori Achillefs Kanaris, me poshte referuar si “**Bleresi**”;

Shitesit dhe Bleresi jane referuar me poshte individualisht si “**Pala**” dhe se bashku si “**Palet**”.

### DEKLARATA PARAPRAKE:

- I. Shitesit jane pronaret e vetem te 2 (dy) kuotave qe perfaqesojne 100% te kapitalit te Shoqerise **ApNet” Sh.p.k.**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit te Republikës se Shqipërisë, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit (“**QKB**”) me date 10.03.2020, me Numer Unik Identifikimi te Subjektit (NUIS) M02710403U dhe me seli ne adresen: Lagja Kongresi i Permetit, Bulevardi “Jakov Xoxa”, pallati nr.5, kati nr.1, Fier, Shqiperi;

- II. **INTEL MEDIA Sh.p.k**, zoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 18,18% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise ApNet shpk e barazvlefshme me 9,085,015.00 Leke dhe **TEEB-CENTER Sh.p.k** zoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 81,82% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise ApNet shpk e barazvlefshme me 40,882,650.00 Leke;
- III. Shitesit deshirojne te shesin Kuotat e tyre tek Bleresi dhe Bleresi deshiron dhe pranon te bleje Kuotat nga Shitesit ("**Transaksioni**").
- IV. Me date 06.03.2020 mes Shitesve dhe shoqerise "ABCOM" shpk eshte nenshkruar nje Kontrate per Shit-blerje Kuotash, e amenduar, e cila parashikon kushtet dhe afatet per shitjen dhe blerjen e Kuotave ne Shitje ("**KSHK**") dhe vendosen te nenshkruajne edhe kete Marreveshje per Shitblerje Kuotash, me qellim regjistrimin e transferimit te pronesise mbi Kuotat ne Shitje, prane Qendres Kombetare te Biznesit ("**QKB**").
- V. Me date 30.12.2020 shoqeria "ABCOM" shpk eshte bashkuar me perthitje nga shoqeria "Vodafone Albania" sh.a dhe te drejtat dhe detyrimet e kontrates kane kaluar plotesisht te shoqeria perthithese "Vodafone Albania" sh.a.
- VI. Meqenese te gjitha kushtet e parashikuara ne Kontraten e Shitjes se kuotave, e amenduar jane permbushur ose hequr sipas nevojës, mbyllja do te realizohet ne daten e kesaj marreveshje.
- VII. Me ane te Vendimit date 28/06/2021 te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise eshte autorizuar tranferimi i Kuotave ne Shitje nga Shitesit tek Bleresi dhe ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe sipas dispozitave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**"). Kuotat ne Shitje mund te transferohen pa pengese nga pronesia e Shitesit ne pronesine e Bleresit.

**PER KETO ARSYE, Palet bien dakord si me poshte:**

1. Shitesit i transferojne ketu Bleresit 2 (dy) Kuotat ne Shitje, per nje çmim blerjeje i cili mund te arrije nje vlere maksimale te barabarte me **678,500 Euro** ("**Çmimi i Blerjes**").
2. Ne daten e nenshkrimit, kesti i pare ne masen 35% te Cmimit te Blerjes ne vleren 237,475 Euro, minus garancine ne masen 15% te kestit te pare dhe çdo rregullim i çmimit dhe tatimin mbi te ardhurat te mbajtur ne burim, ne vleren 135,700 Euro do te kaloje nga Bleresi ne llogarine Bankare te Shitesve, dhe Shitesit do te transferojne 100% te titullit te pronesise mbi te gjithë Kuotat bashke me te gjithë te drejtat e tjera te votes dhe te drejtat e dividendit, dhe Bleresi do te fitoje titull te plote pronesie mbi Kuotat..
3. Bleresi pranon pronesine e ketyre Kuotave ne Shitje dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lidhen me pronesine e ketyre Kuotave ne Shitje sipas parashikimeve te Statutit te Shoqerise dhe Ligjit Tregtar.



4. Shitesit dhe Bleresi bien dakord qe me kerkesen e pare te Pales tjetër, te nenshkruajne dhe te leshojne çdo dokument te nevojshem dhe ne pergjithesi te bejne çdo gje qe eshte e nevojshme qe transferimi i pronesisë mbi Kuotat ne Shitje sipas kesaj Marreveshje, te regjistrohet prane QKB-se, si edhe prane çdo autoriteti tjetër shqiptar, sipas ligjit.


Kjo Marreveshje u hartua ne 5 (pese) kopje origjinale me vlere te njejte, ne gjuhen shqipe. Marreveshja bazohet ne Nenin 705 te Kodit Civil te Republikës se Shqiperise dhe ne Ligjin Tregtar.


## PALET

SHITESIT

INTEL MEDIA Sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori:


  
Z. Hamza Himo




BLERESI

VODAFONE ALBANIA SH.A


Perfaqesuar nga Administratori:

  
Z. Achillefs Kanaris



TEEB-CENTER Sh.p.k

Perfaqesuar nga Administratori:

  
Z. Ilir Nathanaili

